



Drejtuar: Operatorit Ekonomik “B - 93” shpk

Adresa: Lagjja 8 Shkurti, Rruga Andon Doro, zona kadastrale 8533, nr. pasurie 1/270, Fier.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Rikonstruksioni i Bibliotekës së Qytetit NjA 6”

Nr. References, REF 23309 – 05 – 22 -2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është **“Rikonstruksioni i Bibliotekës së Qytetit NjA 6”**, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

Fondi limit: 3. 392.721,7 (tremilion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e një presje shtatë) **lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.159 datë 21.12.2018 për ”Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”, i ndryshuar, me objekt” **Rikonstruksioni i Biblotekës së Qytetit NjA 6”.**

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, 7 (shtatë) javë kalendarike.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 03.06.2019 , Ora: 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 21 datë 27.05.2019.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**
oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk me nr. NIPTI K67106202W

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **0 (zero) lekë**

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “B - 93” shpk, me nr. NIPTI J62903508R

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **2.756.604** (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër) **lekë**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk , me nr. NIPTI K67106202W

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ELDA-VL” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik“ELDA-VL” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “B-93” shpk.

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **2.756.604** (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër) **lekë**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **3.307.924** (tremilion e treqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) **lekë**.

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 7 (shtatë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.06.2019

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, **Operatorin Ekonomik “B - 93” shpk, me nr. NIPTI J62903508R**, me adresë: Fier, Lagjia 8 Shkurti, Rruga Andon Doro, zona kadastrale 8533, nr. pasurie 1/270, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa tvsh = **2.756.604** (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e katër) **lekë**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.